



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 - Nr. 400-24293/12.
Kaçanik; 27. 09.2012.

Në bazë të nenit 40.2. (b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30. të Ligjit nr.03/L-048 - Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 13 dhe 14. të Ligjit nr.04/L-079. - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, të pikes 5. të Vendimit 01-Nr.400-12114/11. të datës 29.09.2011 – Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2012 dhe vlerësimet për vitet 2013-2014. dhe të nenit 61 dhe të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut si dhe nenit 15.1. (b) e Rregullorës për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë :

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E SHUMAVE TË NDARA PËR PROJEKTET KAPITALE
SIPAS NDARJEVE ME BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2012

1. Me këtë vendim lejohen ndryshimet e ndara për projektet kapitale përmes Rialokimit të mjeteve përbrenda programit të Zyrës së Kryetarit (160/16028) në shumë prej 155,545,47 € dhe Transferi i mjeteve nga programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660/66445) në program tjetër buxhetor të Zyra e Kryetarit (160/16028) në shumë prej 10.000,60 €, duke u realizuar një lëvizje e përgjithshme e mjeteve të projektet kapitale përbrenda Organizatës buxhetore në masë totale prej 165.546,07 € .
2. Rialokimi (ridestinimi) i mjeteve të projekteve kapitale sipas pikës 1. të këtij vendimi, do të bëhet te Zyra e Kryetarit (160/16028) përbrenda këtij program buxhetor përmes anulimit të një (01) projekti me KP-86235 në shumë prej 150.000,00 € dhe mbetjës së mjeteve nga dy (02) projekte të përfunduara me KP-86244 dhe KP-86243, duke u ridestinuar këto mjete në dobi të projektit me KP-86237 në shumë prej 54.916,62 €, te projekti me KP-86234 shuma prej 35.710,60 € dhe te projekti me Kod të Ri “Asfaltimi i rrugës në lagjet Bunjak, Koraq dhe Mezin në fshatin Biçec” shuma prej 64.918,25 €.
3. Transferi i mjeteve sipas pikes 1. të këtij vendimi, ka të bëjë me lëvizjen e mjeteve nga projekti me KP-86257 te programi buxhetor i Planifikimit Urban dhe Mjedisit (660/66445), dhe nga Projekti me KP-86253 në dobi të Zyrës së Kryetarit (160/16028) te projekti me Kod të Ri “Asfaltimi i rrugës në lagjet Bunjak, Koraq dhe Mezin në fshatin Biçec” shuma prej 10.000,60 €.
4. Ndryshimet e shumave të ndara për projektet kapitale në detaje janë pasqyruar në dy (02) tabela, të cilat janë të bashkangjitura dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit që t'i ofroi Ministrisë së Financave të gjitha dokumentacionin e nevojshëm për aprovimin dhe zbatimin e tij.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe
3. Arkivi.

Kryesues i Kuvendit
Xhelal Gashi,